

Në pajtim me nenin 20-g paragrafi 1, neni 21 paragrafi 3, neni 22 paragrafi 1 alinea 5, paragrafi 4, paragrafi 6, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 i Ligjit për të punësuarit publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" Nr. 143/19 dhe 14/20), neni 14 paragrafi 2, neni 22 paragrafi 1 alinea 1, neni 23, neni 24, neni 25, neni 26, neni 27 dhe neni 46 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015, 27/16, 134/2016 , 120/18 dhe 110/19) dhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor numër 01-2372/1 nga 03.05.2017, 01-1832/2 nga 12.03.2018, 01-1832/6 nga 02.04.2018, 01-3932/1 nga 16.07.2019, 01-4222/1 nga 31.07.2019, 01-4222/4 nga 04.09.2019, 01-4222/5 nga 07.10.2019 viti, 01-4222/7 nga 15.10.2019, 01-6478/3 nga 30.12.2019, 01-7008/1 nga 30.12.2019, 04-1604/1 nga 02.03.2020 dhe 04-4510/1 e 30.10.2020, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor publikon :

SHPALLJEN PUBLIKE NUMËR- 6/2020

për punësimin e (3) tre përmbaruesve me kohë të caktuar për periudhën deri më 31.12.2020 në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor publikon një Shpallje Publike për punësim / krijimin e marrëdhënieve të punës të (3) tre përmbaruesve të përkohshëm për periudhën deri më 31.12.2020:

- 1. Këshilltar për monitorimin e zbatimit të projekteve të infrastrukturës në qytetin e Manastirit, në kuadër të Njesisë së Projektit për implementimin e projekteve për rindërtimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për realizimin e projektit -Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza urbane në Manastir- dhe projektit -Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve për komunën e Manastirit- në kuadër të IPA 2- 1 përmbarues;**
- 2. Këshilltar për monitorimin e zbatimit të projekteve të infrastrukturës në qytetin e Kërçovës, në kuadër të Njesisë së Projektit për implementimin e projekteve për rindërtimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për realizimin e projektit -Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza urbane në Kërçovë- dhe projekti për -Zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve për komunën e Kërçovës në kuadër të IPA 2-1 përmbarues;**
- 3. Këshilltar për monitorimin e zbatimit të projekteve të infrastrukturës në qytetin e Tetovës, në kuadër të Njesisë së Projektit për implementimin e projekteve për rindërtimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për realizimin e projektit -Ndërtimi i një impianti të trajtimit për trajtimin e ujërave të zeza urbane në Tetovë- dhe projekti për Zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve për komunën e Tetovës në kuadër të IPA 2 – 1 përmbarues;**

Kandidatët duhet ti përmbushin kushtet në vijim :

- të jetë shtetas i R. Maqedonisë
- të përdor maqedonishten në mënyrë aktive
- të jetë i rritur
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë të mos jetë i ndëshkuar me ndalimin e kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në ligj, nevojitet:

Për vendin e punës nga pika 1:

Të kenë të kryer së paku shkallën e VII/1 të arsimimit të lartë ose studime me së paku 240 kredi sipas sistemit EKTC nga sfera e Ndërtimtarisë dhe Ekonomia e Ujërave, Teknologji dhe Prodhimet Ushqimore, Mjedisi Jetësor

- Të njohin në mënyrë aktive njërën nga tre gjuhët më shumë të përdorura të Bashkimit Evropian (anglishten, frengjishten, gjermanishten)
- Të përdor në mënyrë aktive programet kompjuterike për punën në zyrë
- Përvojë pune: së paku 3 vjet përvojë pune në profesion pas diplomimit.
- Orari ditor i punës nga ora 07:30/8:30, deri në ora 15:30/16:30 , orari javor i punës 40 orë -nga e Hëna deri të Premten;
- Paga neto 26.257,00 denarë

Për vendin e punës nga pika 2:

Të kenë të kryer së paku shkallën e VII/1 të arsimimit të lartë ose studime me së paku 240 kredi sipas sistemit EKTC nga sfera e Ndërtimtarisë dhe Ekonomia e Ujërave, Teknologji dhe Prodhimet Ushqimore, Mjedisi Jetësor

- Të njohin në mënyrë aktive njërën nga tre gjuhët më shumë të përdorura të Bashkimit Evropian (anglishten, frengjishten, gjermanishten)
- Të përdor në mënyrë aktive programet kompjuterike për punën në zyrë
- Përvojë pune: së paku 3 vjet përvojë pune në profesion pas diplomimit.
- Orari ditor i punës nga ora 07:30/8:30, deri në ora 15:30/16:30 , orari javor i punës 40 orë -nga e Hëna deri të Premten;
- Paga neto 26.257,00 denarë

Për vendin e punës nga pika 3:

Të kenë të kryer së paku shkallën e VII/1 të arsimimit të lartë ose studime me së paku 240 kredi sipas sistemit EKTC nga sfera e Ndërtimitarisë dhe Ekonomia e Ujërave, Teknologji dhe Prodhimet Ushqimore, Mjedisi Jetësor

- Të njohin në mënyrë aktive njërën nga tre gjuhët më shumë të përdorura të Bashkimit Evropian (anglishten, frengjishten, gjermanishten)
- Të përdor në mënyrë aktive programet kompjuterike për punën në zyrë
- Përvojë pune: së paku 3 vjet përvojë pune në profesion pas diplomimit.
- Orari ditor i punës nga ora 07:30/8:30, deri në ora 15:30/16:30 , orari javor i punës 40 orë -nga e Hëna deri të Premten;
- Paga neto 26.257,00 denarë

Të drejtë të marrin pjesë kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë që plotësojnë kushtet për konkurim. Kandidatët me paraqitje për pjesëmarrje duhet të paraqesin dëshmi për përmbushjen e kushteve në formën origjinale ose një kopje të noterizuar të aplikacionit.

Në formularin e aplikimit është e detyrueshme të shënoni dhe të tregoni vendin e punës për të cilën po aplikoni.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në Arkivin e Ministrisë ose me postë në adresën e mëposhtme: "Presveta Bogorodica nr.3", 1000 Shkup, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Njësia e Burimeve Njerëzore (me shenjën "për shpalljen nr. 6/2020").

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar është tre ditë nga dita tjetër e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

Aplikimi dhe dokumentacioni jo i plotë dhe i vonuar nuk do të shqyrtohen.

Pas zgjedhjes së kandidatëve të aplikuar për plotësimin e vendeve të lira të punës, kandidatët e përzgjedhur do të ftohen gjithashtu për intervistë në ambientet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas së cilës do të bëhet zgjedhja përfundimtare.

Në aplikim, kandidatët janë të detyruar nën përgjegjësinë materiale dhe penale të konfirmojnë që të dhënat në aplikim janë të sakta dhe dëshmitë e paraqitura janë të vërteta ndaj originalit.

VËREJTJE: Kandidati që do të fusë të dhëna të rreme në aplikim ose do të zbulohet se ka futur të dhëna të rreme, do të skualifikohet nga procedura e mëtejshme pas kësaj shpalljeje.

Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimin Hapësinor